

Njoftim: Mundësi punësimi si Operator i Shërbimit ndaj Klientit

Pozicioni: Operator i shërbimit ndaj klientit

Kohëzgjatja: 1 vit

Orari: Kohë e Plotë / Turni i dytë

Arsimi: I lartë

Eksperienca: Minimumi 1 vit punë në kompani të ngjashme

Përse EasyPay?

- Do të jeni pjesë e kompanisë së parë FinTech në Shqipëri, e cila renditet në listën e “Top 3” kompanive FinTech më të mira në Europë dhe është vlerësuar si “Best Payment Solution Provider Albania 2020” nga Global Banking and Finance Review;
- Do të jeni pjesë e një mjedisi dinamik pune, ku do të bashkëpunoni me talente dhe lider në sektorin Fintech në vend;
- Do të punonit në mjedis atraktiv pune, i cili ndodhet në një prej zonave kyce të Tiranës, në ish-Bllok.

Cilat do të jenë përfitimet tuaja?

- Një eksperiencë në sektorin FinTech;
- Mundësi për të zhvilluar më tej aftësitë tuaja profesionale;
- Bashkëpunim me profesionistë në këtë fushë;
- Përfitime financiare.

Cila kandidaturë do të përshtatej më së miri?

Dikush që këmbngul: Zhvillimi i punës në mënyrë diskrete, me përgjegjshmëri dhe devotshmëri. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe ndërpersonale, për të kapërcyer sfidat e përditshme.

Dikush që planifikon: Zbatimi i planit të punës në mënyrë të organizuar, korrekte dhe duke respektuar afatet kohore.

Cilat janë detyrat kryesore që do të zhvilloni?



- Të menaxhoni komunikimet nëpërmjet telefonit dhe postës elektronike (e-mail), drejtuar shërbimit të klientit;
- Komunikimi me rrjetin e agjentëve dhe transmetimi i kërkesave specifike të tyre;
- Asistimi i klientëve dhe transmetimi i kërkesave specifike të tyre drejt departamenteve përkatëse;
- Të kryeni njoftimet përkatëse drejt klientëve për çdo ndryshime në procedurë të punës, prezantime të produkteve të reja, etj;
- Mirëmbani kontaktet me klientët;
- Monitoroni procesin e porosive dhe pagesave dhe bashkëpunoni ngushtë me gjithë departamentet;
- Monitoroni procesin e shërbimit të transfertave duke udhëzuar klientët dhe agjentët që e ofrojnë shërbimin;
- Të menaxhojë shpejt dhe saktë situatat ditore.

Cilat janë kualifikimet që duhet të keni?

- Diplomë e Arsimit të Lartë (preferohen në degën Ekonomi-Financë/ Informatikë Ekonomike/Administrim Biznes ose në degë të ngjashme);
- Njohuri të mira mbi paketën Office 2010;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Preferohen kandidatët me njohuri dhe eksperiencë mbi sistemin e pagesave elektronike, apo në kompani me profil të ngjashëm.

Dokumentacioni paraprak: CV, kopje të Diplomave dhe kualifikimeve të ndryshme, të dërgohen me email në adresën: hr@easypay.al, brenda dates 20 Maj 2021.

**Do të lajmërohen për intervistë vetëm kandidatët që do të perzgjidhen.*

